



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:148800

Datë: 07.03.2025

Numri i dokumentit: 06956401

PKR.nr.143/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, me zyrtaren ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi - procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit G.J. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale - Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.125/2018 të datës 12.12.2018, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 13.02.2025 i cili ka qenë i hapur për publikun, në prezencën e palëve Prokurorit të shtetit Fetije Bajrami, të akuzuarit G.J. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av.Dijar Dinaj, me datë 14.02.2025 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me datë 07.03.2025 e përpiloi me shkrim këtë :

A K T G J Y K I M

- Kundër të akuzuarit:

G.J., me nofkën “.....”, nga i ati dhe e ëma, e vajzërisë, i lindur me datë 27.01.1995, në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, Rr.“.....”, Nr....., me numër personal:, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Pa autorizim është furnizuar dhe ka poseduar me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca narkotike të llojit marihuanë ashtu që, me datë 17.09.2018, rreth orës 14:55 min., policia me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka bërë kontrollimin

e lokalit-kafiteria “.....”, në Rr.“.....”- Mitrovicë, pronë e të pandehurit G.J. dhe gjatë kontrollit në banakun e lokalit është gjetur substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë 0.29 gram, kurse në tualet saktësisht në guaskë (shole), janë gjetur 7 (shtatë) paketime me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë rreth 7.08 gram, pastaj policia kanë bërë kontrollimin e objektit përcjellës në Rr.“Fazli Barani”, në Mitrovicë të të pandehurit G.J. dhe në brendi të objektit janë gjetur 2 (dy) çese të ndara me substanca narkotike të llojit marihuanë, njëra me peshë rreth 24.45 gram, ndërsa tjetra me peshë rreth 520.91 gram, ku pas ekzaminimit laboratorik të substancës narkotike – bimore me ngjyrë të gjelbërt, rezultati i ekspertimit ka treguar se është prezent kanabisi (marihuana) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 552.73 ± 0.0001 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale – Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 69, 73, 74, 75 par.1, pika 1.3 dhe 76 par.1, pika 1.4 dhe neni 273 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së të akuzuarin e :

- G J Y K O N -

I.- Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe **Dënim me Gjobë** në shumën prej tetëqind (800.00) Euro të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Të akuzuarit në bazë të nenit 83 të KPRK-së në dënimin me burgim, i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 17.09.2018 deri më datë 17.12.2018.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga Gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të i llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 273 par.5 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, Urdhëron konfiskimin e përhershëm: të substancës narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 552.73 ± 0.0001 gram.

IV.- Autorizohet Policia e Kosovës që pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë, të bëjë asgjësimin e substancës narkotike.

V.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale shumë dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50.00 € (pesëdhjetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

VI.- Kërkesë pasurore – juridike sipas aktakuzës nuk kishte.

A r s y e t i m

- Aktakuza -

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.125/2018, të datës 12.12.2018, kundër të akuzuarve G.J. dhe G.M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

- Rrjedha e procedurës penale -

Më datë 13.02.2025 Gjykata në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar e cila ka qenë e hapur për publikun, në prezencën e palëve Prokurorit të shtetit Fetije Bajrami, të akuzuarit G.J. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av.Dijar Dinaj, si dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare të të akuzuarit G.M., Av. Ali Rexha.

- Në këtë seancë ka munguar i akuzuari G.M., të cilit Gjykata i ka dërguar ftesë të rregullt për seancë në adresën si në shkresat e lëndës mirëpo, zarfi i është kthyer gjykatës i mbyllur me konstatimin e dorëzuesit se *“Pala ka ndryshuar adresë”*. Gjykata iu ka drejtuar Policisë së Kosovës – Stacionit Policor Mitrovicë Jug me kërkesë për verifikimin e adresës së tij dhe të njëjtit me parashtrësën me shkrim dorëzuar përmes e-mailit zyrtar datë 31.01.2025 kanë njoftuar Gjykatën se i njëjti gjendet jashtë vendit në Norvegji, në adresë të pasaktësuar.

Gjykata pas marrjes së mendimit të palëve në procedurë, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale dhe efikasitetit të saj tani për tani ndaj të akuzuarit të parë G.J., meqenëse ndaj të akuzuarit të dytë G.M. Gjykata ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale ligjore të konstatuara si më lartë, në kuptim të nenit 35 par.1 dhe par.2 të KPP – së, ka marrë Aktvendim procedural për veçimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit G.M. nga Mitrovica, dhe lënda ka marrë numër të ri PKR.nr.8/2025.

- Gjykata konform nenit 241 par.1 të KPP-së, të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale, ka deklaruar se nuk ka angazhuar mbrojtës mirëpo, është pajtuar që sipas detyrës zyrtare të vazhdojë ta mbrojë av.Mbrojtës Dijar Dinaj.

- Duke qenë se në këtë çështje penale i akuzuari akuzohet për veprën penale- Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënim me Gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, meqë mbrojtja është e detyruar, me aktvendim procedural Gjykata duke vepruar në përputhje me nenin 56 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike të akuzuarit i është caktuar Av.Dijar Dinaj nga Mitrovica.

Gjykata rikujton se në këtë çështje penale, kishte marrëveshje me shkrim mbi pranimin e fajësisë PP.nr.125/2018 datë 10.12.2018, e cila ishte arritur në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, ndërmjet Kryeprokurorit të kësaj prokurorie dhe prokurorit të shtetit në njërin anë dhe në anën tjetër të akuzuarit dhe av.mbrojtës të tij, por që të njëjtit-i mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari, në shqyrtimin fillestar kanë deklaruar se heqin dorë nga kjo marrëveshje për shkak të ndryshimit të rrethanave personale dhe familjare të të akuzuarit, andaj Gjykata ka vazhduar me shqyrtimin fillestar sipas dispozitave ligjore të KPP-së.

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë –

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, Gjykata të akuzuarin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe benificionet e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, njëherësh shprehu pendim të thellë lidhur me këtë rast, duke theksuar se nuk e përdorë më substancën narkotike dhe as nuk e ka përdorë prej asaj kohe për çka lidhur me sjelljet dhe veprimet e tij sinqerisht ka kërkuar falje.

- Gjykata, ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe atë nga prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, e cila ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që pranimin e fajësisë i akuzuari e deklaroi në mënyrë vullnetare,

pa inponime, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë dhe pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit.

- Mbrojtësi i të akuzuarit G.J., av. Dijar Dinaj lidhur me pranimin e fajësisë së të mbrojturit të tij ka deklaruar se: pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës dhe pas njoftimit me pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë i mbrojturi im në mënyrë të vullnetshme e pranon fajësinë duke i kuptuar ato andaj, i propozojë gjykatës që të bëjë aprovimin e fajësisë, dhe nëse Gjykata aprovon pranimin e fajësisë atëherë i propozojmë gjykatës që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese për të pandehurin G.J., shprehjen e pendesës së sinqertë të tij për kryerjen e kësaj veprë penale e sidomos Gjykata t'i ketë parasysh rrethanat se që nga koha e kryerjes së veprës penale i njëjti nuk ka kryer vepër tjetër penale, koha e kaluar që nga koha e kryerjes së veprës penale mbi 7 vite andaj, Gjykata edhe gjatë kohës që ka qenë ligji penal në fuqi ekzistojnë rrethanat posaqërisht lehtësuese për të cilat Gjykata mund ti shqiptojë një dënim dukshëm më të butë me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

- Gjendja faktike e vërtetuar –

- Gjykata në mbështetje të nenit 242 par.2, lidhur me par.6 të KPP-së, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i akuzuari dhe ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimi të fajësisë. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga i akuzuari mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit G.J. në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Departamenti për Krime të Rënda me datë 03.10.2018; Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit G.J. në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Departamenti për Krime të Rënda me datë 10.12.2018; Raporti fillestar i incidentit i datës 17.09.2018; Shënimi zyrtar me nr. 2018-DHTN-836, i DHTN-Mitrovicë i datës 17.09.2018; Shënim Zyrtar UGJK.nr. 55/2018, i datës 17.09.2018 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda; Procesverbali mbi intervestimin e të dyshuarit (pandehurit) G.J., i datës 17.09.2018, në Policinë e Kosovës – Stacioni Policor në Mitrovicë; Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, i datës 17.09.2018; Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve nga i akuzuari G.J. i datës 17.09.2018; Procesverbalin me nr.serik 0003237 te Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Inspektionit i datës 17.09.2018; Raportin e kqyrjes së vendit të ngjarjes së bashku me fotoalbumin me gjithsej 29 fotografi si dhe listën e dëshmimeve të policisë Njësia e Forenzikës në Mitrovicë i datës 17.09.2018; Raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-2887/2018-2849 i datës 09.11.2018; Raporti i ekspertizës te policia

e Kosovës – Drejtoria e teknikës kriminalistike – sektori për fotografi videoanalizë si dhe vështrimi në të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Të gjitha provat si më lartë janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë tyre dhe pranimit të fajësisë nga i akuzuari, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale - Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

- Gjykata gjen se i akuzuari në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij para dhe gjatë seancës. Gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë nuk mund të ushtrojë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humbet mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që i shkon në favor të akuzuarit me rastin e caktimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata konstaton se aktakuza në këtë rast nuk përmban ndonjë shkelje ligjore apo ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e saj.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –

- Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarin ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës, ashtu që si rrethana rënduese janë marrë parasysh; dashjen direkte, kontributin e tij te vepra penale, sasinë e narkotikëve që ka poseduar, faktin se kjo natyrë e veprave penale paraqet rrezikshmëri të lartë për shoqërinë dhe për shëndetin e qytetarëve, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shpeshtuara në Kosovë, të shprehura e në tendencë të rritjes.

Përveç rrethanave të sipërtheksuara, si rrethanë tjetër rënduese Gjykata mori dënimet e mëparshme penale ndaj tij ngase sipas parashtrësës me shkrim të datës 14.02.2025 nga Zyra për Menaxhimin e Lëndëve të kësaj Gjykate verifikuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK), ka konstatuar se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale të narkotikëve dhe atë për veprën penale – Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.135/2017 i plotëfuqishëm me datë 22.06.2017; Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.492/2017 i plotëfuqishëm me datë 09.07.2018; dhe Posedim i paautorizuar i

narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK – së sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.916/2020 i plotëfuqishëm me datë 01.03.2021.

Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, ka shprehur publikisht keqardhje dhe pendim për rastin. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që akuzohet, duke ndihmuar në zbardhjen e plotë dhe të tërësishme të veprës penale dhe kjo rrethanë është marrë për bazë për aplikimin e zbutjes së dënimit, mbështetur edhe nenin 75 paragrafi 1 nën –paragrafi 1.3 lidhur me nenin 76 par.1, nënpar. 1.4 të KPRK-së.

- Gjykata me rastin e caktimit të dënimit, vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 75 par.1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, në të cilën dispozitë ligjore parashihet se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rast kur kryesi pranon fajësinë. Në rastin konkret i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, në të gjitha fazat e procedurës penale, andaj Gjykata të njëjtit i shqiptojë dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjor për këtë veprë penale, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit e ka bërë në kuadër të kufijve për zbutjen e dënimit të paraparë në dispozitën ligjore nga neni 76 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, në të cilën parashihet “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim”. Në rastin konkret për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale: - Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

- Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj si dhe dënimi me gjobë në shumën prej tetëqind (800.00) euro ndaj të akuzuarit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të tij. Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të akuzuarin Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës për çka i ka lënë afatin e pagesës në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve.

- Sa i përket përshkrimit faktik të veprës penale në bashkëkryerje, meqenëse nga dispozitivi i aktakuzës dhe përshkrimi faktik i veprës penale, janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe të saktë veprimet inkriminuese për secilin të akuzuar veç e veç duke iu gjetur secilit dhe sasia e caktuar e substancës

narkotike, për sa i përket të akuzuarit G.J. në bazë të Raportit të ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2018-2887/2018-2849 i datës 09.11.2018 dhe dëshmime më numër rendor nga Dëshmia#2 deri tek Dëshmia#5, është konstatuar se substanca narkotike e gjetur te ky i akuzuar është e llojit Kanabis (Marihuanë), me përmbajtje Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 552.73 ± 0.0001 gram, Gjykata sipas detyrës zyrtare bëri plotësimin e saj në masën e lejuar dhe nga këto arsye dhe rrethana, ka ndryshuar duke plotësuar përshkrimin faktik të veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo dhe për faktin se i akuzuari ka pranuar në tërësi kryerjen e kësaj vepre penale siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, përkatësisht në përshkrimin faktik të veprës penale lidhur me veprimet inkriminuese të tij.

- Andaj, Gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Llogaritja e masës së paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar –

- Sipas nenit 83 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përcaktohet koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë. Mbi këtë bazë, Gjykata ia ka llogaritur të akuzuarit G.J. kohën e kaluar nën masën e paraburgimit dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga data 17.09.2018 e deri me datë 17.12.2018, në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

- Vendimi për konfiskim –

- Gjykata vendosi si në pikën –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 273 par.5 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së ashtu që, ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 552.73 ± 0.0001 gram, për të cilat ka autorizuar Policinë e Kosovës që pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë, të bëjë asgjësimin e kësaj substance.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, Gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Meqenëse palë të dëmtuar dhe kërkesë pasurore – juridike sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit nuk kishte, Gjykata për këtë çështje nuk vendosi fare.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.143/2018 datë 07.03.2025.

Zyrtarja Ligjore:

Atdhetare Bashota Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari:

Fatos Sejdiqaj

- **KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.